

KOSOVA RREZIKON TË MBETET PA FONDE NGA PLANI I RRITJES I BE-së

Kosova rrezikon humbjen e fondeve të BE-së për shkak të vonës në krijimin e institucioneve. Mungesa e institucioneve pengon gjithashtu zbatimin e reformave, duke rritur rrezikun që fondet nga Plan i Rritjes të humbasin deri në vitin 2027. Plan i Rritjes, që mbulon periudhën 2024-2027, përmban një paketë prej 6 miliardë eurosh, e miratuar nga BE-ja në fund të vitit 2023, për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Analistët thonë se raportet e Kosovës me BE-në janë në nivelin më të ulët në shtatë paku një dekadë - me koordinim dhe komunikim të minimalizuar

AKTUALE



BEGAJ I KËRKON VIETNAMIT TA NJOHË PAVARËSINË E KOSOVËS F. 5

KOSOVA E PRANON SE BELGJIKA KA SHPREHUR INTERESIM PËR SHFRYTËZIMIN E BURGJEVE TË SAJ F. 7

PËR 9 MUJ 230 RASTE ME KANCER GJIRI NË KOSOVË F. 6

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI MIRËPRET NË VIZITË GJENERALIN E KOMANDËS SË KARABINIERËVE KUNDËR FALSIFIKIMIT MONETAR F. 8

BIE NUMRI I PËRFITUESVE TË PENSIONEVE INVALIDORE TË PUNËS F. 8

SPORT




FFK-ja ME HAPA TË RËNDËSISHËM PËR SIGURINË NË FUTBOLL, SHPËRNDAN DEFIBRILATORË MODERNË PËR KLUBET F. 11



GËRVALLA NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-së: SERBIA KREU AGRESION TË DREJTPËRDREJTË NDAJ KOSOVËS NË BANJSKË F. 2

SUPREMJA PRANON ANKESËN E AAK-SË PËR JUNIKUN, PZAP-ja DETYROHET TA SHOYRTOJË KËRKESËN PËR RIVOTIM F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BRENDA FABRIKËS SË DRONËVE KAMIKAZË NË BULLGARI

SOFJE, 22 TETOR - Një seri vizitash prej zyrtarëve qeveritarë dhe atyre të ushtrisë bullgare në qytezën e vogël Samokov në muajt e fundit, vë në pah rëndësinë në rritje të pajisjeve që po prodhon një kompani. Fabrika Samel-90, e cila gjendet në jug të kryeqytetit bullgar, Sofje, i ka nisur operacionet në vitet '90, duke prodhuar pajisje elektronike për ushtrinë bullgare. Mirëpo tani, në kohën e avancimeve të shpejta ushtarake, sidomos në fushëbetejë në Ukrainë, kompania është duke prodhuar armë ajrore dhe sisteme anti-dronë. “Ne kemi nisur t’i prodhojmë dronët kamikazë dy vjet më parë”, ka thënë Veneta Popova, udhëheqëse e prodhimit në fabrikë, në disa përgjigje për Radion Evropa e Lirë. “Ne aktualisht i prodhojmë rreth 50 për muaj, por kemi kapacitet ta trefishojmë këtë numër”, ka shtuar ajo. Brenda fabrikës, pajisjet që ngjasojnë me dronët kamizë

Geran-2 të iranianëve, janë në faza të ndryshme të prodhimit. Samel-90 është privatizuar pas rrëzimit të regjimit socialist në këtë shtet më 1989, dhe tani është në pronësi të Petar Georgievit, dikur punëtor në fabrikë. Georgiev tregon se kompania ka vërejtur rritje të madhe të interesimit për dronë, tani që i gjithë fokusi në Evropë është tek ata, përfshirë edhe sistemet kundër dronëve. Ndonëse Brukseli po e çon përpara propozimin e një “mburoje dronësh” për ta mbrojtur krahun lindor, Georgiev i ka thënë Radios Evropa e Lirë se nuk e ka të qartë kontributin që mund ta japin pajisjet Samel-90 për përpjekjet për mbrojtje të BE-së. “Mund të ketë një vend për neve, por gjithçka varet nga Qeveria e Bullgarisë”, ka thënë Georgiev. Pajisjet e kësaj kompanie për bllokim të sinjaleve të dronëve tashmë shiten në Indi, Egjipt dhe “vende të tjera në Lindje”, me një fraksion çmimi të

versioneve të Evropës Perëndimore, që prodhohen me të njëjtën teknologji. Georgiev tregon se tash për tash shtetet e Perëndimit nuk janë duke e blerë teknologjinë bullgare. “Pajisjet tona janë po aq të mira, por secili shtet i kërkon prodhuesit e vet”, ka thënë ai. Një dron me krahë fluturues që e prodhon kompania, i quajtur Samjet, është shumë më i vogël sesa pajisja tjetër e ngjashme iraniano-ruse dhe në përputhje me madhësinë, edhe kokën e ka më të vogël. Samjet përdor një motor elektrik që nuk bën zhurmë sikurse dronët Geran, por ka kapacitet për rreze veprimi relativisht të shkurtër prej rreth 100 kilometrash, në krahasim me 1 000 kilometra të dronëve Geran. Sipas Borislav Lazarovit, për të ndërtuar një dron Samjet nevojiten prej 3 ditë deri në 1 javë, nga fillimi deri në fund. Kina është aktualisht lidere në botë sa i përket teknologjisë së dronëve. Kompania e saj DJI



mbulon 70 për qind të shitjeve të dronëve në gjithë botën. Pjesa më e madhe e teknologjisë së dronëve të kompanisë kineze, sikurse sistemet e gjurmimit vizual, përdoren edhe në ushtri, prandaj analistët nuk kanë asnjë dyshim se kështu po modernizohen programet e saj të dronëve ushtarakë. Për pronarin e fabrikës Samel-

90, armët dhe teknologjia anti-dronë që po prodhohen në Samakov janë pikësëpari asete bullgare në kohën e shkundjes së situatës së sigurisë në Evropë. “Na duhet të marrim vetë iniciativa dhe kur them ‘ne’, e mendoj Bullgarinë si shtet. Besoj se kemi mjaftueshëm kapacitete teknologjike dhe nuk duhet ta nënvlerësojmë veten”, ka thënë ai.

SHTËPIA E BARDHË THOTË SE NUK KA PLANE TË MENJËHERSHME PËR NJË TAKIM TRUMP-PUTIN

UASHINGTON, 22 TETOR - Një zyrtar i lartë i Shtëpisë së Bardhë ka thënë të martën vonë se nuk ka plane që presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe lideri i Rusisë, Vladimir Putin, të takohen “në të ardhmen e afërt”, pavarësisht se disa ditë më herët Trumpi kishte thënë se po organizohej një takim tjetër mes tij dhe presidentit rus. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, dhe ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, gjithashtu nuk kanë plane të takohen personalisht, u tha gazetarëve zyrtari amerikan, duke shtuar se një bisedë telefonike mes tyre ishte “frytdhënëse”. Ky sqarim vjen pas raportimeve se bisedimet përgatitore midis diplomatëve më të lartë të të dyja vendeve kishin ngecur, gjë që me shumë gjasë do të vonojë takimin e propozuar. Zëvendësministri i Jashtëm rus,



Sergei Ryabkov, tha se as një takim i tillë nuk ishte planifikuar fare. “Diçka për të cilën nuk je pajtuar paraprakisht nuk mund ta shtysh. Ne nuk e konfirmuam atë që disa burime perëndimore shkruan dje. Ne nuk kishim asnjë marrëveshje në lidhje me kohën apo vendin e një kontakti

të tillë”, u citua ai të ketë thënë nga agjencia e lajmeve RIA Novosti. Mundësia për një takim mes Trumpit dhe Putinit në Budapest u shfaq gjatë një telefonate midis dy udhëheqësve më 17 tetor. Pritshmëritë ishin që Rubio dhe

Lavrov të takoheshin për të vënë themelet para bisedimeve. Ata e zhvilluan vetëm një bisedë telefonike më 20 tetor. Duke folur të martën, Lavrov tha se ishte pajtuar me Rubin për vazhdimin e konsultimeve telefonike “për të kuptuar më mirë ku jemi dhe si të ecim në rrugën e duhur”. Ai tha se qëllimet ushtarake të Rusisë mbeten të pandryshuara dhe se “operacioni i saj i posaçëm ushtarak” do t’i arrijë synimet e veta. Lavrovi e përsëriti gjithashtu kundërshtimin e Rusisë ndaj armëpushimit të menjëhershëm, duke thënë se është e nevojshme të gjendet një zgjidhje që i eliminon ata që Kremlinin e quan “shkaktarët rrënjësorë” të luftës. Trumpi kishte thënë më 17 tetor se forcat ruse dhe ukrainase duhet të “ndalen aty ku janë” në fushën e betejës. Më herët, Departamenti i Shtetit

tha në një deklaratë se Rubio kishte “theksuar rëndësinë e angazhimeve në vijim si një mundësi për Moskën dhe Uashingtonin për të bashkëpunuar në avancimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme për luftën Rusi-Ukrainë, në përputhje me vizionin e presidentit Trump”. Trumpi tha më 20 tetor se përpjekjet për të arritur një marrëveshje midis Rusisë dhe Ukrainës për të ndaluar luftën janë duke vazhduar dhe paralajmëroi se nëse marrëveshja nuk arrihet, pasojat do të jenë serioze. “Ne ende jemi në proces për të bërë një marrëveshje [për të ndaluar luftën]. Nëse e bëjmë, do të jetë fantastike. Nëse jo, shumë njerëz do të paguajnë një çmim shumë të rëndë”, tha Trumpi në një takim në Shtëpinë e Bardhë me kryeministrin australian Anthony Albanese.


Gazetarët e burgosur, Andrzej Poczobut dhe Mzia Amaglobeli, fitojnë Çmimin Sakharov 2025

STRASBURG, 22 TETOR - Çmimi Sakharov 2025 u është ndarë dy gazetarëve - polako-bjellorusit Andrzej Poczobut dhe georgjanes Mzia Amaglobeli - të cilët janë duke vuajtur dënime në burgim për akuza të lidhura

me punën e tyre në raportimin mbi demokracinë dhe shoqërinë civile. Konferenca e Presidentëve e Parlamentit Evropian, që përbëhet nga presidentja e PE-së, Roberta Metsola, dhe

nga udhëheqësit e tetë grupeve politike, shpalli fituesit më 22 tetor. “Të dy janë gazetarë që ndodhen në burg për akuza të sajura, thjesht sepse kanë bërë punën e tyre dhe kanë ngritur zërin kundër

padrejtësisë”, tha Metsola. “Guximi që kanë treguar i ka shndërruar në simbole të luftës për liri dhe demokraci. Ky institucion qëndron përkrah tyre dhe përkrah të gjithëve që vazhdojnë të kërkojnë liri”, shtoi ajo.



GËRVALLA NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-SË: SERBIA KREU AGRESION TË DREJTPËRDREJTË NDAJ KOSOVËS NË BANJSKË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 22 tetor - Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, në fjalën e saj para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka theksuar se Serbia ka dëshmuar se është e gatshme për luftë dhe se regjimi i Vuçiqit mund të ndalet vetëm përmes parandalimit, jo bindjes. Ajo rikujtoi se në shtator të vitit 2023 Serbia kreu një sulm të nivelit ushtarak kundër Kosovës, duke dërguar paramilitarë të trajnuar në bazat e saj ushtarake dhe të pajisur me armatim të sofistikuar, me qëllim që ta shkëpuste me forcë territorin verior të Republikës së Kosovës. “Komandanti i atij sulmi ishte dora e djathtë e Vuçiqit për Kosovën, i cili sot trajtohet si ‘mysafir nderi’ në Beograd”, ka deklaruar ministria Gërvalla. Ajo përmendi edhe rastin e arrestimit të ish-zyrtarit policor Arbnor Spahiu nga autoritetet serbe, duke e quajtur atë një akt hakmarrjeje ndaj atyre që mbrojtën Republikën e Kosovës nga sulmi në Banjskë, ndërsa Spahiu ndodhej jashtë vendit në kohën e sulmit. “Nëse nuk ka pasoja për veprime të tilla, Serbia do ta përshkallëzojë më tej agresionin. Ai regjim nuk ka frikë nga fjalët, por vetëm nga veprimi”, është shprehur

ministria Gërvalla, duke kërkuar edhe lirim të ish-zyrtarit policor Arbnor Spahiu.

“Serbia nuk i fsheh synimet agresive ndaj Kosovës”

Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, në fjalën para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, paralajmëroi për rrezikun e vazhdueshëm që paraqet Serbia për paqen dhe stabilitetin në rajon. Ajo shfaqti para të pranishmëve fotografi me murale dhe grafitë në Serbi që glorifikojnë kriminelët e luftës dhe ushqejnë frymën e urrejtjes ndaj Kosovës me mbishkrimin “Kur ushtria të kthehet në Kosovë”. “Nuk shkruhet ‘nëse ushtria serbe kthehet në Kosovë’. Shkruhet ‘kur’. Ata nuk i fshehin synimet e tyre, janë të qartë, haptazi. Vetëm kohën e lënë të paqartë”, ka thënë ministria Gërvalla.

Ajo ka theksuar se ndonëse Kosova mbetet e përkushtuar ndaj dialogut, ky dialog duhet të jetë i vërtetë dhe parimor, jo një lojë mashtrimi e regjimit të Vuçiqit, i cili ndaj BE-së përdor strategjinë e mashtrimit, ndërsa ndaj fqinjëve ushtron luftë hibride dhe agresion paramilitar. “Serbia është vendi i vetëm në rajon që po përgatitet

ushtarakisht për konfrontim. Ajo është e armatosur nga Rusia dhe Kina, dhe për herë të parë ka zhvilluar stërvitje ushtarake në territorin e Kinës. Ky është realiteti, jo interpretim politik”, ka pohuar ministria Gërvalla. Ajo ka theksuar se Kosova, si shteti më i vogël në rajon, ka interesim për paqe, por nuk do të pranojë as kërcënime, as shantazhe, duke i bërë thirrje Këshillit të Sigurimit të reagojë me vendosmëri ndaj politikave destabilizuese të Serbisë.

“UNMIK-u duhet ta përfundojë misionin në Kosovë, nuk i shërben më asnjë qëllimi”

Në adresimin e saj para Këshillit të Sigurimit, zëvendës-kryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka deklaruar se “UNMIK-u duhet të mbyllet. Është një humbje e madhe parash të OKB-së. Nuk i shërben më asnjë qëllimi”.

Më tej ministria Gërvalla ka theksuar se nëse UNMIK-u do të largohej nesër, asgjë nuk do të ndryshonte në Kosovë dhe për qytetarët e saj. “Ne kemi institucione demokratike, agjenci ndërkombëtare dhe organizata të OKB-së që po bëjnë punë të shkëlqyer”, u shpreh ministria Gërvalla. Ajo ka thënë se raportet e



njëanshme të UNMIK-ut nuk pasqyrojnë të vërtetën e zhvillimeve në terren, duke i injoruar faktet që dëshmojnë përparimin demokratik të Kosovës dhe përkushtimin e saj ndaj paqes dhe sundimit të ligjit. Ministria Gërvalla ka ritheksuar se Kosova po ecën me vendosmëri në rrugën e saj euroatlantike, ndërsa rajoni i Ballkanit do ta gjejë paqen e plotë vetëm atëherë kur Serbia të heqë dorë nga ideologjia e saj agresive dhe ekspansioniste.

Gërvalla ka denoncuar përfshirjen e strukturave të regjimit të Vuçiqit në nxitjen e dhunës, krimit të organizuar dhe propagandës kundër Kosovës. Ajo ka theksuar se ministri i Jashtëm aktual i Serbisë, Marko Gjuriq,

është bashkëpunëtor i afërt i kriminelëve që organizuan sulmin në Banjskë. “Pas agresionit paramilitar, ai u ul për kafe me mikun e tij, vrasësin Radoiçiq. Kjo është pamja e vërtetë e politikës serbe”, ka deklaruar ministria Gërvalla. Gërvalla, po ashtu, shtoi se Kosova, përkundrazi, ka luftuar me sukses ndikimin e krimit të organizuar dhe ka çliruar qytetarët e saj serbë nga kapja e strukturave kriminale të kontrolluara nga Beogradi. “Asnjë nga këto nuk gjendet në raportet e UNMIK-ut, të cilat shpesh janë të njëanshme dhe anashkalojnë faktet bazike”, ka thënë ajo, duke kërkuar nga OKB-ja një vështrim të drejtë e të paanshëm mbi realitetin në terren.

KURTI SHPREH GATISHMËRI QË KOSOVA T’I STREHOJË AZILKËRKUESIT E REFUZUAR NGA BRITANIA

PRISHTINË, 22 TETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka shprehur gatishmëri që vendi i tij t’i strehojë azilkërkuesit e refuzuar nga Mbretëria e Bashkuar në këmbim të mbështetjes në fushën e sigurisë.

Kurti, i cili ndodhet në Londër për Samitin e Procesit të Berlinit, tha për gazetën e përditshme britanike “Times” se “ne duam ta ndihmojmë Mbretërinë e Bashkuar”. “E vlerësojmë këtë si detyrën tonë miqësore dhe politike. Kemi kapacitete të kufizuara, por duam të ndihmojmë dhe, ndërkohë që flasim, ka komunikim të rregullt midis ekipeve tona të zyrtarëve shtetërorë nga Ministria jonë e Punëve të Brendshme dhe juristëve për mënyrën se si ta bëjmë këtë proces sa më të qetë dhe të dobishëm për të dyja palët”, theksoi Kurti.

Ai shtoi se, në këmbim, Kosova do të dëshironte “të marrë kryesisht mbështetje në fushën e sigurisë, qoftë përmes marrëveshjeve strategjike, apo



përmes pajisjeve dhe projekteve që mund t’i realizojmë”. “Natyrisht, duam që si vend të përfitojmë, por e konsiderojmë, para së gjithash, detyrën tonën t’ju ndihmojmë, sepse ju na keni ndihmuar shumë dhe këtë nuk do ta harrojmë kurrë”, nënvizoi

ai. Muaj më parë Qeveria në detyrë e Kosovës ishte shprehur e hapur për të biseduar me Britaninë për ndërtimin e qendrave për strehimin e azilkërkuesve të refuzuar nga ky vend. Por kjo është hera e parë

që ajo ofron haptazi se është e gatshme për këtë dhe Kurti i bëri këto komente një ditë para samitit që do të udhëhiqet nga kryeministri britanik, Keir Starmer, dhe në të cilin ai do të marrë pjesë.

Më herët këtë vit, organizata

Human Rights Watch (HRW) i bëri thirrje Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian që të mos e përdorin Ballkanin si “magazinë për migrantët”.

Michael Bochenek nga kjo organizatë tha në qershor për Radion Evropë e Lirë se Ballkani është bërë cak i planeve të tilla të shteteve më të fuqishme për disa arsye. “Vendet e Ballkanit nuk kanë historik vërtet të tmerrshëm të shkeljeve të të drejtave të njeriut [krahasuar me vendet e tjera që janë përdorur për këto plane, si Ruanda, Sudani Jugor, Libia], tha ai.

Ndërkohë, së fundi, Kosova u pajtua t’i strehojë 50 migrantë nga shtete të treta që qëndronin në ShBA, ndërsa gjatë tetorit Kosova është përfolur si vend i mundshëm për të strehuar të burgosur nga Belgjika.

Më parë Kosova kishte strehuar edhe rreth 1 900 shtetas afganë që ishin evakuuar nga Afganistani pas rikthimit të talibanëve në pushtet në vitin 2021.



KOSOVA RREZIKON TË MBETET PA FONDE NGA PLANI I RRRITJES I BE-së

Kosova rrezikon humbjen e fondeve të BE-së për shkak të vonesës në krijimin e institucioneve. Mungesa e institucioneve pengon gjithashtu zbatimin e reformave, duke rritur rrezikun që fondet nga Plani i Rritjes të humbasin deri në vitin 2027. Plani i Rritjes, që mbulon periudhën 2024-2027, përmban një paketë prej 6 miliardë eurosh, e miratuar nga BE-ja në fund të vitit 2023, për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Analistët thonë se raportet e Kosovës me BE-në janë në nivelin më të ulët në së paku një dekadë - me koordinim dhe komunikim të minimalizuar

PRISHTINË, 22 TETOR - Kosova rrezikon humbjen e fondeve të BE-së për shkak të vonesës në krijimin e institucioneve. Mungesa e institucioneve pengon gjithashtu zbatimin e reformave, duke rritur rrezikun që fondet nga Plani i Rritjes të humbasin deri në vitin 2027. Analistët thonë se raportet e Kosovës me BE-në janë në nivelin më të ulët në së paku një dekadë - me koordinim dhe komunikim të minimalizuar. Zvarritja e procesit të konstituimit të Kuvendit dhe krijimit të qeverisë së re, Kosovës mund t'i kushtojë me humbjen e fondeve nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian

për Ballkanin Perëndimor, paralajmërojnë njohësit e integritimeve evropiane. Plani i Rritjes, që mbulon periudhën 2024-2027, përmban një paketë prej 6 miliardë eurosh, e miratuar nga BE-ja në fund të vitit 2023, për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Për të përfituar nga këto fonde, vendet duhet t'i përfundojnë reformat e kërkuara nga BE-ja, që përfshijnë sektorin privat, tranzicionin e gjelbër dhe digjitalizimin. Nga kjo paketë, Kosova mund të përfitojë mbi 880 milionë euro, prej të cilave mbi 250

milionë si grant pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formë kredie me kushte të favorshme. Megjithatë, vendi nuk e ka përfituar pjesën e para-financimit - prej 61 milionë eurosh - që tashmë u është ndarë Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Këtyre vendeve u janë ndarë edhe mjete të reja javën e kaluar. Jashtë përfitimeve mbetet edhe Bosnjë-Hercegovina e cila nuk e ka miratuar në kohë agjendën e reformave dhe Planin e Rritjes. Kosova ishte ndër të parat që miratoi agjendën e reformave, por fondet mbeten të bllokuara për shkak të mungesës së institucioneve që ta ratifikojnë marrëveshjen formale me BE-në. “Kjo dërgon një sinjal negativ në Bruksel, ku frustrimi i institucioneve dhe shteteve anëtare po vazhdon të rritet për shkak të sjelljes së elitës politike të Kosovës”, thotë Donika Emini, hulumtuese në Grupin Këshillëdhënës në Evropë për Politikën e Ballkanit (BiEPAG), për Radion Evropa e Lirë. Kuvendi i Kosovës u shpall i konstituuar më 10 tetor por, ndërkohë, procesi u kontestua në Gjykatën Kushtetuese nga Lista Serbe. Vendi, po ashtu, mbetet ende me qeveri në detyrë, edhe pse kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka marrë mandatin për formimin e ekzekutivit të ri.

Fondet e BE-së për Kosovën “mund të rishpërndahen”

Sipas Bekim Salihut, nga Instituti për Hulumtime të Avancuara - GAP, vonesat në konstituimin e institucioneve bllokojnë jo vetëm fondet, por edhe zbatimin e reformave. “Pamundësia e Kosovës për t'i marrë fondet duhet të përkthehet si pamundësi e Kosovës për t'i bërë reformat. Reformat natyrisht që mund të bëhen në një periudhë të caktuar, por po shihet se dinamika e tyre do të jetë e vonshme, e ngadalshme”, thotë ai. Kështu mendon edhe Donika Emini. Ajo shpjegon se mosmarrja e fondeve nga Plani i Rritjes nuk do të thotë se paratë e dedikuara për Kosovën do të humbasin automatikisht. Megjithatë, nëse Kosova dështon t'i tërheqë dhe t'i përdorë këto fonde gjatë gjithë periudhës së programit, rreziku i humbjes është shumë i lartë. Sipas Eminit, për shkak të vonesave në miratimin e marrëveshjes nga Kuvendi dhe mungesës së një qeverie me mandat të plotë, zbatimi i planit të reformave në Kosovë do të nisë shumë më vonë se në disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. “... dhe kjo e penalizon shumë. Vendi duhet të fitojë qasje në fonde duke

implementuar reformat e agjendës që është aprovuar nga BE-ja. Pra, këto janë fonde për të cilat duhet punuar dhe zbatuar reforma specifike. Kosova tashmë ka humbur shumë kohë”, thotë Emini. Në vazhden e kësaj, ajo paralajmëron se mungesa e reformave mund t'i bllokojë pagesat e BE-së, duke lënë shuma të mëdha të papërdorura deri në vitin 2027. “... dhe nëse në fund të periudhës programore fondet nuk janë përdorur ose kushtet nuk janë përmbushur, BE-ja mund t'i rishpërndajë ato [fonde] te vendet ose projektet që kanë përmbushur kushtet më shpejt”, thotë Emini. Emrush Ujkani, drejtor ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, thekson se Plani i Rritjes është vetëm një nga mjetet e BE-së në agjendën e saj për integrimin e Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, BE-ja nuk do t'i ndalojë proceset e nisura për shkak të vonesave të vendeve të caktuara në përmbushjen e kritereve evropiane. “Në këtë drejtim, në qoftë se mjetet nuk do të merren - kjo vlen edhe për instrumentet e tjera - ato do të rishpërndahen, që i bie, jo te ne, por do të ketë rishpërndarje te vendet e tjera që janë në këtë proces”, thotë Ujkani. Sipas tij, planifikimi i BE-së lidhur me zbatimin e Planit të Rritjes ishte që të ecej në mënyrë konstante me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Begaj i kërkon Vietnamit ta njohë pavarësinë e Kosovës

PRISHTINË, 22 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, ka pranuar të mërkurën Letrat Kredenciale nga ambasadorja e Republikës Socialiste të Vietnamit në Republikën e Shqipërisë, Pham Thi Thu Huong. Kreu i Shtetit vlerësoi

marrëdhëniet e mira dhe tradicionale që ekzistojnë midis dy vendeve prej 75 vjetësh, duke nënvizuar nevojën për shtim të kontakteve politike, ekonomike dhe kulturore. Presidenti Begaj ka theksuar se Shqipëria do ta mirëpriste një

rishikim të qëndrimit të Vietnamit lidhur me njohjen e Republikës së Kosovës dhe mbështetjen e anëtarësimit të saj në organizata ndërkombëtare, duke nënvizuar se Kosova është një realitet i pakthyeshëm në Ballkanin Perëndimor.



LV-ja, SHPENZIMET MË TË MËDHA PARTIAKE NË TREMUJORIN KORRIK-SHTATOR 2025

PRISHTINË, 22 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka rezultuar subjekti me shpenzimet më të larta ndër partitë e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës për tremujorin korrik-shtator 2025. Të dhënat zyrtare janë publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas dorëzimit të raporteve financiare nga partitë parlamentare, në bazë të obligimeve ligjore për transparencë. Sipas raportimeve në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP), Vetëvendosje ka deklaruar shpenzime në vlerë prej 663,459 eurosh, që përfshijnë aktivitetet politike, funksionimin e partisë dhe shpenzimet operative të tremujorit. Pas saj radhitet Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

me një shumë prej 220,660 eurosh, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka raportuar shpenzime prej 188,533 eurosh për periudhën e njëjtë. Ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka paraqitur shpenzimet më të ulëta mes partive parlamentare, me gjithsej 40,765 euro. Raportet financiare janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së si pjesë e zbatimit të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike i cili i obligon partitë të raportojnë në baza tremujore për mënyrën se si i shpenzojnë fondet publike dhe private. KQZ theksoi se publikimi i këtyre të dhënave synon rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik në menaxhimin financiar të subjekteve politike, veçanërisht në prag të proceseve zgjedhore.



Numërimi i votave me kusht drejt fundit

PRISHTINË, 22 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) po shkon drejt përfundimit numërimi i fletëvotimeve me kusht për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Sipas KQZ-së, votimi me kusht është zhvilluar në 54

vendvotime në 38 komuna, ndërsa procesi i numërimit ka filluar të martën dhe pritet të përmbyllet shumë shpejt. Pas kësaj faze, gjatë ditës së mërkurë do të nisë numërimi i fletëvotimeve të personave me nevoja të veçanta, votim që është realizuar përmes ekipeve mobile jashtë

vendvotimeve. Mbi 3 467 qytetarë janë regjistruar si votues me nevoja të veçanta. Në QNR tashmë ka përfunduar edhe skanimi i Listës së Votuesve, një proces që shërben për të verifikuar nëse ka raste të votimit të dyfishtë, duke krahasuar listat e rregullta me ato të votimit me kusht.



“Prandaj, nuk ka kohë që t’i kthehet një procesi prapa, për çka është planifikuar në kohën e duhur. Nëse [vendi i caktuar] ka dështuar që t’i bëjë veprimet konkrete, përgjegjësinë do ta marrë vetë”, thotë Ujkani për Radion Evropa e Lirë. Ai thekson se nëse Kosova dështon t’i tërheqë fondet e BE-së për reforma, kjo nuk do të thotë se reformat nuk do të kërkohen - ato do të financohen më vonë nga vetë buxheti i Kosovës. Komisioni Evropian njoftoi në prill të vitit 2024 se nëse partnerët e Ballkanit Perëndimor nuk i përmbushin kushtet, pagesat mund të pezullohen pjesërisht ose plotësisht.

Komisioni Evropian sqaroi, gjithashtu, se pas një pezullimi të tillë dhe “në rast se partnerët e Ballkanit Perëndimor nuk i plotësojnë kushtet përkatëse gjatë një periudhe mospagimi prej një viti [ose dy vjetësh nga viti i parë i zbatimit], shuma e pezulluar do të tërhiqet dhe mund të rishpërndahet midis përfituesve të tjerë në vitet pasuese”.

Raportet Kosovë - BE, “në nivelin më të ulët”

Vonesat e Kosovës në formimin e legjislativit dhe ekzekutivit të ri, që nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare më 9 shkurt e deri më tash, kanë bërë që situata të vështirësohet edhe

në aspektin e komunikimit zyrtar të institucioneve të Kosovës me Bashkimin Evropian. Në muajin gusht zyrtarët e BE-së kanë njoftuar se nuk do të zhvillojnë takime brenda ndërtesës së Qeverisë së Kosovës derisa vendi të ketë një ekzekutiv me mandat të plotë. Emini thekson se ky është një mesazh shqetësues në adresë të autoriteteve të Kosovës lidhur me mungesën e institucioneve funksionale. “Ka humbur kanali i komunikimit dhe koordinimit me BE-në për reformat, si dhe marrëdhëniet diplomatike në mes të Kosovës dhe BE-së”, thotë ajo. Këto marrëdhënie Salihu i sheh në nivelin më të ulët në

dekadën e fundit. Sipas tij, në mungesë të një qeverie me mandat të plotë dhe të një kuvendi të pakontestuar ligjërish, Kosova e ka të vështirë të komunikojë me BE-në për raportet e ndërsjella dhe proceset integruese. “Ju e shihni, nuk përmendet më mundësia e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, nuk përmendet më mundësia e heqjes së masave [ndëshkuese] ndaj Kosovës. Raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian konsideroj se janë më të ulëta në këta 10 vjetët e fundit, pas nënshkrimit të MSA-së [Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim]”, thotë Salihu. Kosova dështoi të anëtarësohet

në Këshill të Evropës në vitin 2024. Vendi vazhdon të jetë nën masat ndëshkuese të BE-së të cilat u vendosën në qershor të vitit 2023 për shkak të rritjes së tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Njohësit e integriteteve evropiane vlerësojnë se zvarritja edhe më tej e formimit të institucioneve të reja “e mirëmban” hendekun në raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Sipas tyre, ai mund të thellohet edhe më tej në rast se vendi eventualisht shkon në zgjedhje të parakohshme parlamentare për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet partive politike për formimin e institucioneve të reja.

Klinika e Neurologjisë pranon donacion pajisje për analiza të elektroliteve

PRISHTINË, 22 TETOR - Klinika e Neurologjisë në QKUK ka pranuar një donacion me rëndësi të veçantë nga Rotary Club Prishtina i cili përfshin pajisjen moderne EXIAS e1 Analyzer - një analizator i avancuar për analiza të elektroliteve, i dizajnuar për përdorim në pika të kujdesit të shpejtë apo pranë pacientëve.

Pajisja EXIAS e1 Analyzer është kompakte dhe ofron matje të shpejta (brenda 25 sekondave), me një sasi minimale të mostrës dhe mat parametra të rëndësishëm, të cilat janë jetike për monitorimin e pacientëve neurologjikë në kushte intensive apo të ndërlikuara klinike. Dr. Nexhmedin Shala, përfaqësues nga Klinika e

Neurologjisë, theksoi rëndësinë e këtij donacioni. “Kjo pajisje do të ndihmojë ndjeshëm në përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve tanë. Është një pajisje e nevojshme për punën tonë të përditshme. Falënderojmë sinqerisht Rotary Club Prishtina për mbështetjen dhe kontributin konkret në shëndetësinë publike”, ka thënë

ai. Pajisja është e lehtë për përdorim dhe nuk kërkon trajnim të specializuar për stafin, gjë që e bën atë edhe më të dobishme për nevojat e përditshme të klinikës. Ky donacion është pjesë e angazhimeve të Rotary Club Prishtina për t'i përkrahur institucionet shëndetësore në



vend me pajisje bashkëkohore dhe mbështetje konkrete në fushën e shëndetësisë.

PËR 9 MUAJ 230 RASTE ME KANCER GJIRI NË KOSOVË

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 TETOR - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka mbajtur mbledhje, e cila i është dedikuar Muajit Rozë, muajit të vetëdijesimit për luftën kundër kancerit të gjirit. Mbledhjen e hapi Tetore Olloni, kryesuese e Bordit, e cila tha se përmes Nafije Latifit, Tetori Rozë nuk sjell vetëm ngjyra dhe kordele rozë, por mbetet kampanë alarmi dhe simbol i solidaritetit. Sipas saj, me një kauzë fisnike që ajo ka ndjekur për dy dekada, ka trokitur në ndërgjegjen e secilit, duke bartur dhimbjen e mijëra grave dhe rikthyer shpresën për jetën, andaj ShSKUK-ja po e hap portën e madhe për Nafije si e ftuar nderi. Anëtarët e Bordit Drejtues të ShSKUK-së theksuan rëndësinë e



diagnostikimit të hershëm, kujdesit të integruar dhe mbështetjes së pacienteve, duke u zotuar për vazhdimin e bashkëpunimit profesional dhe institucional. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, ndau mirënjohjen e veçantë për Latifin, për kontributin e jashtëzakonshëm

mbi dy dekada, me përkushtim në përkrahje të kauzës humane për pacientët me kancer dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore në vend. Drejtori Azizi tha se falë punës, humanizmit dhe vizionit të Latifit shumë pacientë kanë gjetur mbështetje, forcë dhe shpresë në përballjen me sfidat e

jetës, andaj meriton vlerësim dhe falënderim të thellë për rolin e pazëvendësueshëm në ngritjen e vetëdijes publike dhe promovimin e solidaritetit njerëzor në fushën e onkologjisë. Nafije Latifi, kryetare e Shoqatës “JETA/VITA”, theksoi se prej 19 vjetësh qëndrojnë në terren, në kontakt me qytetarët dhe profesionistët e shëndetësisë. Sipas saj, qëllimi ka qenë gjithmonë informimi dhe vetëdijesimi për zbulimin e hershëm të sëmundjes dhe shpëtimin e jetëve. Ajo theksoi se lufta kundër kancerit të gjirit nuk fitohet vetëm me kirurgji dhe barna, por edhe me empati, ndjeshmëri dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Gjatë takimit u zhvilluan diskutime nga drejtues të klinikave që merren me trajtimin e kancerit, duke theksuar se të

gjitha shërbimet ofrohen në sektorin publik, pa pasur nevojë që pacientët të shpenzojnë për trajtim. Ilir Kurtishi, drejtor i Klinikës së Onkologjisë, theksoi se për 9 muaj kanë pasur 230 raste me kancer gjiri (4 meshkuj). Shkëndije Nuza, drejtoreshë e Klinikës së Radiologjisë, pohoi se për nëntë muaj kanë kryer 1200 mamografi, 1975 eho gjiri, 480 rezonanca gjiri, si dhe 230 biopsi. Violeta Zatriqi, drejtoreshë e Klinikës së Kirurgjisë Plastik, tha se janë kryer 140 operime, fillimisht vendoset ekspander indor, pastaj implante, me përfshirje të muskulit. Nazmi Kolgeci, drejtor i Kirurgjisë Torakale, tha se për nëntë muaj janë kryer 230 operacione gjiri (74 sentinell, 58 kirurgji kuruese si dhe 140 biopsi eksicionale).

GAP-i PËR KOMUNAT: MJETET E PLANIFIKUARA PËR NDËRTIMIN E RRUGËVE APO QENDRAVE KULTURORE JANË PËRDORUR PËR PAGESA PËRMBARIMORE

PRISHTINË, 22 TETOR - Instituti GAP ka publikuar analizën “Paraqitja jo e saktë e investimeve kapitale komunale: implikimet për transparencë dhe monitorim”. Analiza trajton problemin e raportimit jo të saktë të shkallës së realizimit të investimeve kapitale nga komunat në raportet e Thesarit të Kosovës. Gjetjet tregojnë se për shkak të proceseve përmbartimore me të cilat po përballen komunat - kryesisht obligime që burojnë nga marrëveshje dhe ligje të nivelit qendror (si kontratat

kolektive në arsim dhe shëndetësi) - fondet e planifikuara për investime kapitale po përdoren gjithnjë e më shpesh për mbulimin e këtyre obligimeve. Megjithatë, këto pagesa vazhdojnë të paraqiten si shpenzime kapitale në raportet e Thesarit. Si pasojë, indikatorët e realizimit të investimeve kapitale janë të fryrë dhe jorealë, duke krijuar pamundësi për monitorim të saktë të punëve publike. Në disa raste të gjitha mjetet e planifikuara për ndërtimin e rrugëve apo qendrave kulturore



janë përdorur për pagesa përmbartimore, por në raporte figurojnë si realizim 100 % i

projekteve. Instituti GAP rekomandon që raportet financiare të Thesarit të

përditësohen për t'i ndarë qartë shpenzimet për zbatim të punëve nga ato për pagesa gjyqësore. Po ashtu, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet ta rishikojë metodologjinë e Grantit për Performancë Komunale, pasi që nga viti 2024 kriteret aktuale nuk po arrijnë ta reflektojnë qëllimin thelbësor të Grantit - mbështetjen e komunave me performancë më të mirë - por në praktikë po favorizojnë komunat me më pak raste përmbartimore të lidhura me kontratat kolektive.

Supremja pranon ankesën e AAK-së për Junikun, PZAP-ja detyrohet ta shqyrtojë kërkesën për rivotim

PRISHTINË, 22 TETOR - Kolegji i Gjykatës Supreme e ka pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Junik, dhe ka prishur vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ZL. Anr. 217/2025, të datës 15.10.2025. Çështja është kthyer në

rivendosje në PZAP. Pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës kishte hedhur të palejuar ankesën e subjektit politik AAK, kjo e fundit ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke propozuar, mes të tjerash, që “të shpallen të paligjshme zgjedhjet komunale dhe komuna e Junikut të shkojë

në rivotim për shkak të shkeljeve të cekura në ankesë, të cilat kanë ndikuar në rezultatin zgjedhor”. Gjykata Supreme e Kosovës nuke ka pranuar të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP lidhur me hedhjen poshtë si të palejuar të ankesës të parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me

seli në Junik, duke konsideruar se ankesa është dashur të trajtohej në bazë të meritave dhe jo të hedhet poshtë si e palejuar. Ndaj, Kolegji i Gjykatës Supreme, përmes aktgjykimit AA. nr. 92/2025, ka kërkuar nga PZAP që në rivendosje t'i evitojë shkeljet e evidentuara ligjore dhe të vendosë në mënyrë meritore



lidhur me ankesën e subjektit politik AAK.

KOSOVA E PRANON SE BELGJIKA KA SHPREHUR INTERESIM PËR SHFRYTËZIMIN E BURGJEVE TË SAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - Belgjika ka shprehur interesim për t'i marrë në shfrytëzim institucionet korrektuese në Kosovë, tha të mërkurën për Radion Evropa Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK).

Në javët e fundit Kosova ka qenë e përfolur në planet e Belgjikës për burgjet, pasi vendi i Bashkimit Evropian është duke e shqyrtuar mundësinë e ndërtimit ose marrjes me qira të një burgu jashtë vendit.

Në një përgjigje me shkrim për REL-in, ShKK tha se, pas marrëveshjes së Kosovës me Danimarkën për dhënie në shfrytëzim të Burgut të Gjilanit për të strehuar të burgosur danezë, “disa shtete të tjera, përfshirë edhe Belgjikën, kanë shprehur në forma të ndryshme interesim për marrjen në shfrytëzim të institucioneve korrektuese të Kosovës”. Megjithatë, ky institucion nuk ka sqaruar se në çfarë forme është shprehur ky interesim, duke theksuar se “nuk ka pranuar asnjë shkresë zyrtare lidhur me këtë çështje”.

ShKK-ja, gjithashtu, nënvizoi se nuk ka kompetencë për trajtimin e kërkesave në nivel

ndërkombëtar që lidhen me dhënie në shfrytëzim të institucioneve korrektuese.

Dy zyrtare belge vizituan Kosovën në fillim të tetorit, duke i shtuar zërat për mundësinë e diskutimit të një marrëveshjeje për burgjet. Ministrja belge e Drejtësisë, Annelies Verlinden, dhe ministrja e Azilit dhe Migrimit, Anneleen Van Bossuyt, qëndruan në Kosovë më 6 tetor, ku u takuan me presidenten Vjosa Osmani dhe me ushtruesin e detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu.

Asnjëra nga këto institucione nuk ishin përgjigjur REL-it asokohe në pyetjen nëse ishte bërë një kërkesë e tillë nga zyrtaret belge. Madje as në njoftimet zyrtare për media nga këto institucione nuk ishte përmendur që gjatë takimeve ishte folur për ndërtimin apo marrjen me qira të ndonjë burgu.

Por, REL-i kishte mësuar se kjo çështje ishte përmendur shkurtimisht nga zyrtaret belge, “pa u hapur ndonjë diskutim i hollësishëm nga pala e Kosovës”. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë kanë kritikuar arritjen e mundshme të një marrëveshjeje të tillë.



Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), plani i përfolur i Belgjikës për të dërguar të burgosur në Kosovë paraqet rrezik për sigurinë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

Në vitet e fundit Kosova ka shprehur gatishmëri për të strehuar qoftë të burgosur të huaj, emigrantë nga vendet e treta, apo edhe azilkërkues të refuzuar, me gjithë kritikën.

Të martën, kryeministri në detyrë

Albin Kurti, tha në Londër se Kosova është e gatshme t'i strehojë azilkërkuesit e refuzuar nga Mbretëria e Bashkuar në këmbim të mbështetjes në fushën e sigurisë. Së fundmi, ai u pajtua t'i strehojë 50 migrantë nga shtete të treta që qëndronin në ShBA.

Në një marrëveshje të ngjashme që, po ashtu, kishte nxitur kritika, në vitin 2022, Kosova dhe Danimarka u pajtuan për dhënie me qira të 300 qelive

burgu në Institucionin Korrektues në Gjilan, për të strehuar të burgosur të huaj që pritet të dëbohen nga Danimarka pas përfundimit të dënimit. Në këmbim, Kosova do të përfitojë mbi 200 milionë euro, që do të investohen në Shërbimin Korrektues dhe në projekte të energjisë së ripërtërishme.

Të burgosurit e parë nga Danimarka pritet të transferohen në burgun në Gjilan në pjesën e parë të vitit 2027.

KËRKUAN 200 EURO PËR KALIMIN E TESTIN PRAKTIK TË VOZITJES, AKTAKUZË NDAJ PESË PERSONAVE

PRISHTINË, 22 TETOR - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë kundër pesë personave A. B., E. Q., F. S., S. M. dhe V. V. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprat penale “Marrja e ryshfetit”. Sipas aktakuzës, e pandehura A. B., në cilësinë e personit zyrtar - instruktore në auto-shkollën “A. B. A. F”, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka pranuar dobinë pasurore nga e dëmtuara në shumën prej 200.00 (dyqind) eurosh, në mënyrë që kësaj të fundit t'i mundësohet kalimi i testit praktik të vozitjes. Me këto veprime e pandehura A. B. ka



kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit” sipas KPRK-së. Po ashtu, të pandehurit F. S., E. Q., S. M. dhe V. V., që nga data

04.04.2025, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat për

licencim dhe ndryshim të kushteve hapësinore të autoshkollave, duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje dhe me dijeni të plotë, kanë tejkaluar kompetencat dhe detyrimet e tyre ligjore, me qëllim që të përfitojnë dobi materiale në mënyrë të kundërligjshme. Me këto veprime, të pandehurit F. S., E. Q., S. M. dhe V. V. kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 414 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Ndërkaq, ndaj të pandehurit E. L., prokurori i shtetit ka nxjerrë

aktvendim për pushimin e pjesshëm të hetimeve, lidhur me veprën penale “Marrja e ryshfetit”, sipas nenit 421 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që i pandehuri ta ketë kryer këtë vepër penale.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka theksuar se mbetet e përkushtuar për luftimin e veprave penale të korrupsionit si dhe për ndjekjen penale të të gjithë personave të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit dhe garantimit të llogaridhënies institucionale.

FSK-ja realizon ushtrimin fushor “Ujku shigjetë”

PRISHTINË, 22 TETOR - Forca e Sigurisë së Kosovës përmes Regjimentit të Tretë të Komandës së Forcave Tokësore është duke zhvilluar ushtrimin fushor “Ujku shigjetë”. Ky ushtrim vjen pas një cikli të gjatë trajnimesh dhe përgatitjesh intensive në

kuadër të procesit të validimit të regjimentit.

Gjatë këtij ushtrimi po testohen aftësitë dhe kapacitetet luftarake të njësisë në nivel taktik me qëllim që të vlerësohet gatishmëria operacionale dhe përbushja e standardeve të kërkuara për

validim.

Përmes ushtrimeve të tilla, FSK-ja vazhdon ta demonstrojë përkushtimin ndaj ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe operacionale në përputhje me standardet e forcave moderne të mbrojtjes.



Dogana e Kosovës shënon rritje të sekuestrimit gjatë muajit tetor

PRISHTINË, 22 TETOR - Dogana e Kosovës ka realizuar një performancë gjatë muajit tetor, duke shënuar rritje të konsiderueshme të aktiviteteve operacionale. Në njoftim theksohet se vetëm gjatë gjysmës së parë të tetorit

janë sekuestruar mallra me vlerë mbi 250 000 euro, përfshirë substanca narkotike, municion, monedha dhe dekorata koleksionuese prej bakri, pajisje elektronike, produkte farmaceutike, suplemente, kozmetikë,

instrumente mjekësore, tekstil, piqe, duhan dhe municion. Këto veprime, sipas njoftimit, dëshmojnë angazhimin e Doganës për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e interesit publik, duke parandaluar

rezikimin e ekonomisë dhe shëndetit të qytetarëve nga mallrat e paligjshme. Po ashtu, Dogana e Kosovës ka arritur të mbledhë 1.5 miliard euro deri në mesin e muajit tetor 2025, duke regjistruar një rritje prej 8.8 % krahasuar me të njëjtën



periudhë të vitit të kaluar, që përbën 122 milionë euro më shumë të hyra të inkasuara.

GUVERNATORI ISMAILI MIRËPRET NË VIZITË GJENERALIN E KOMANDËS SË KARABINIERËVE KUNDËR FALSIFIKIMIT MONETAR

PRISHTINË, 22 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Fusha me bashkëpunëtorë, priti në takim gjeneralin e Komandës së Karabinierëve kundër Falsifikimit Monetar, Gianluca Vitagliano, i shoqëruar nga Pier Luigi Ferri. Guvernatori Ismaili fillimisht e njoftoi gjeneralin Vitagliano lidhur me mandatin, detyrat dhe përgjegjësitë e BQK-se, me theks në aktivitetet e ndërmarrja nga BQK në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT), luftën kundër parave të falsifikuara, si projektin e ri në luftën kundër falsifikimit të parave. Duke e informuar për zhvillimet në fushën e pagesave si në aspekt të integritetit drejt SEPA si dhe për infrastrukturën e re të pagesave të shpejta, guvernatori u ndal te lufta kundër falsifikimit të valutës euro, ku theksoi bashkëpunimin e

shkëlqyeshëm me institucionet relevante të Republikës së Kosovës. Ai informoi lidhur me përparimin në hartimin e legjislacionit për themelimin e Qendrës Kombëtare Kundër Falsifikimit të Parasë, me mbështetje nga Banka Qendrore e Kroacisë dhe Zyra e BE-së në Prishtinë, në kuadër të programit TAIEX së Bashkimit Evropian. Gjatë takimit në BQK u diskutua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e luftës kundër falsifikimit të valutës, në kuptim edhe të projektit të bashkëfinancuar nga Komisioni Evropian që synon forcimin e bashkëpunimit me autoritetet e Kosovës dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale për parandalimin dhe identifikimin e falsifikimeve. Drejtuesit e BQK-së e njoftuan delegacionin e karabinierëve italianë lidhur me disa hapa të tjerë të rëndësishëm të ndërmarrë



nga BQK në këtë drejtim, duke përfshirë nënshkrimin në gusht 2025 të Marrëveshjes me Bankën Qendrore Evropiane (BQE) në fushën e luftës kundër falsifikimit të kartëmonedhave euro.

Derisa guvernatori Ismaili e falënderoi delegacionin italian për vizitën, shprehi vlerësimin më të lartë ndaj mbështetjes së institucioneve italiane dhe të Bashkimit Evropian, duke

theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të koordinimit me partnerët evropianë për ruajtjen e integritetit të valutës dhe forcimin e sigurisë monetare në vend.

DELEGAÇIONI I AKB-së, VIZITË ZYRTARE NË KINË ME FTESË TË AUTORITETEVE TË LARTA EKONOMIKE



PRISHTINË, 22 TETOR - Me ftesë zyrtare nga autoritetet e larta ekonomike të Republikës Popullore të Kinës, një delegacion i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), i udhëhequr nga kryetari Agim Shahini, po qëndron për vizitë zyrtare në Kinë. Gjatë qëndrimit në këtë shtet me zhvillim të fuqishëm ekonomik, delegacioni i AKB-së pati mundësinë të vizitojë disa prej fabrikave dhe bizneseve më të suksesshme kineze, ku u mbajtën takime

me përfaqësues të lartë institucionalë dhe ekonomikë. Në kuadër të kësaj vizite janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet kompanive kineze dhe partnerëve nga Ballkani Perëndimor, me fokus në investime, transferim të teknologjisë dhe zgjerim të bashkëpunimit ekonomik në rajon. Këto marrëveshje u nënshkruan në praninë e delegacionit të AKB-së, duke dëshmuar rëndësinë strategjike që Kina i kushton rajonit tonë.

Së shpejti pritet të nënshkruhet edhe një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Aleancës Kosovare të Bizneseve dhe institucioneve ekonomike kineze, që synon forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, nxitjen e investimeve kineze në Kosovë dhe mbështetjen për bizneset e Kosovës që duan të hyjnë në tregun kinez. Delegacioni ishte i përbërë edhe nga afaristët Shkëlzen Jusaj, Feriz Imeri dhe Miftar Kastrati.

Bie numri i përfituesve të pensioneve invalidore të punës

PRISHTINË, 22 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin shtator 2025. Në muajin shtator 2025, krahasuar me muajin shtator 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-26,8%;

skema për pensionet e Trepçës (-19,7%); skema e ndihmës sociale (-12,1%); skema për pensionet familjare (-10,7%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-2,2%); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-1,7%); skema për veteranët e luftës (-

0,7%). Në muajin shtator 2025, krahasuar me muajin shtator 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (9,0%); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (8,5%); skema e

pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (8,2%); skema e pensioneve bazike të moshës (6,7%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimi që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (4,9%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (4,0%);



skema e kompensimeve për personat e verbër (1,9%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (1,3%).

KOREJA E VERIUT LËSHON RAKETA BALISTIKE DREJT DETIT TË JAPONISË

Koreja e Veriut ka lëshuar disa raketa balistike drejt Detit të Japonisë (i njohur ndryshe si Deti Lindor), në testin e parë të këtij lloji pas 5 muajsh. Ngjarja ndodh një javë para Forumit të Bashkëpunimit Ekonomik Azi-Paqësor (APEC), që do të zhvillohet nga 31 tetori deri më 1 nëntor në Seul, të Koresë së Jugut, ku pritet të marrin pjesë liderët kryesorë botërorë, përfshirë presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Ushtria e Koresë së Jugut ka njoftuar se ka identifikuar disa raketa balistike me rreze të shkurtër të lëshuara nga një zonë në jug të Phenian-it, në rajonin Junghwa të provincës Hwanghae. Raketat kanë përshkuar rreth 350 kilometra në drejtim verilindor. Komanda e Përbashkët e Forcave të Armatosura të Koresë së Jugut nuk ka dhënë detaje të mëtejshme mbi fluturimin, por ka theksuar se raketat nuk kanë rënë në det, ndërsa ka shtuar se ushtria mbetet në gatishmëri për të përballuar çdo provokim nga Koreja e Veriut, falë aleancës së fortë ushtarake me SHBA-të. Ky është lëshimi i parë i këtij lloji që nga marrja e detyrës nga presidenti i ri jugkorean, Lee Jae-myung, në qershor, i cili është zotuar të rikthejë klimën e dialogut me Phenian-in, pas viteve të tensionit të krijuar nga administrata konservatore e

mëparshme. Testi i fundit i Koresë së Veriut u zhvillua më 8 maj, kur vendi testoi sisteme me rreze të shkurtër që simuluan kundërsulme bërthamore ndaj forcave amerikane dhe jugkoreane.

Qeveria japoneze ka raportuar se asnjë nga raketat e lëshuara nuk ka rënë brenda zonës së saj ekonomike ekskluzive. Kryeministrja e re Sanae Takaichi, në ditën e saj të dytë në detyrë, ka ndryshuar agjendën për të ndjekur nga afër situatën dhe ka urdhëruar ministrin e Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme të mbledhin informacion për të garantuar sigurinë publike.

Lëshimi ndodh në një moment të tensionuar diplomatik, me Trump-in që pritet të mbërrijë në Seul më 29 tetor për të marrë pjesë në APEC, dhe më pas më 1 nëntor do të vizitojë Gyeongju-n, së bashku me liderë të tjerë botërorë. Presidenti amerikan ka deklaruar se shpreson për një takim të ri me Kim Jong-un, pas tre samiteve të mbajtura gjatë mandatit të tij të parë në Singapor (2018), Hanoi (2019) dhe në zonën e demilitarizuar mes dy Koreve, përpara se negociatat të dështonin për shkak të mungesës së marrëveshjes mbi denuklearizimin.

Nga ana e tij, Kim Jong-un ka dhënë sinjale për rifillimin e mundshëm të bisedimeve, por



me kushte të qarta: Shtetet e Bashkuara duhet të heqin dorë nga, siç e quan ai, “obsesioni delirant për denuklearizimin” dhe të pranojnë një “bashkëjetesë paqësore”, sipas mediave shtetërore të Koresë së Veriut. Në shtator, lideri i Phenian-it deklaroi se ruan “kujtime të bukura për Trump” dhe se është i gatshëm ta takojë sërish “nëse Uashingtoni pranon realitetin”. Ndërkohë, Koreja e Veriut po vazhdon të zhvillojë programet e saj rakitore dhe bërthamore. Muajin e kaluar, Kim Jong-un

mbikëqyri testin e fundit të një motori me karburant të lëngshëm për raketat me rreze të gjatë, që mund të paraprijë një tjetër lëshim eksperimental në muajt në vijim. Në tetor, gjatë një parade ushtarake në Phenian, në prani të zyrtarëve të lartë rusë dhe kinezë, regjimi paraqiti raketën e re balistike ndërkontinentale Hwasong-20, të cilën autoritetet e përshkruan si “më të fuqishmen ndonjëherë” me një rreze veprimi “pa kufij”. Shtetet e Bashkuara kanë

kërkuar prej vitesh që Kim Jong-un të heqë dorë nga armët bërthamore, por regjimi ka përsëritur vazhdimisht se nuk ka asnjë synim për çarmatim, duke e justifikuar programin e tij si një kundërpërgjigje ndaj kërcënimeve nga SHBA-të dhe aleatët e saj, përfshirë Korenë e Jugut. Ndërkohë, Phenian-i po forcon gjithnjë e më shumë lidhjet me Kinën dhe Rusinë, me të cilat ka rritur bashkëpunimin ushtarak dhe diplomatik.

TRUMP HEDH POSHTË OFERTËN PËR BISEDIME ME PUTIN: NUK DUA NJË TAKIM TË KOTË

Takimi i paralajmëruar mes Donald Trump dhe Vladimir Putin në Budapest duket se nuk do të ndodhë në të ardhmen e afërt.

Ishte fillimisht Shtëpia e Bardhë që njoftoi se nuk kishte plane për një takim të afërt mes dy udhëheqësve, ndërsa më vonë edhe presidenti amerikan deklaroi se nuk dëshironte një tjetër takim të shkuar dëm. Trump sugjeroi se një mosmarrëveshje kyçe mbetet refuzimi i Moskës për të pushuar luftën përgjatë vijës aktuale të frontit. Dallimet kryesore mes propozimeve amerikane dhe ruse për paqen, të cilat u bënë edhe më të qarta këtë javë, duket se minuan shanset për një samit.

“Jo, nuk dua të kem një takim të kotë. Nuk dua të humbas kohë. Do të shohim se çfarë do të ndodhë. Por ne kemi bërë të gjitha këto marrëveshje të mëdha, marrëveshje paqeje. Të gjitha janë marrëveshje paqeje,



marrëveshje të forta, secila prej tyre. Por për këtë rast thashë: shkoni në vijën e frontit, në vijën e betejës. Pastaj tërhiquni dhe kthehuni në shtëpi, merrni pak kohë për veten, sepse kemi dy vende që po vrasin njëri-

tjetrin. Dy vende që po humbasin nga 5 deri në 7000 ushtarë në javë. Kështu që do të shohim se çfarë do të ndodhë. Nuk kemi marrë ende një vendim”. Trump dhe Putin zhvilluan një takim në Alaska i cili nuk prod-

hoi rezultate konkrete. Vendimi i Shtëpisë së Bardhë për të pezulluar planet për një përballje të dytë mes tyre, mund të shihet si një përpjekje për të shmangur një skenar tjetër të ngjashëm.

“Besoj se Rusët kërkuar me shumë se ç’ duhet dhe u bë e qartë për amerikanët se nuk do të kishte marrëveshje për Trumpin në Budapest”, tha një diplomat i lartë evropian për Reuters. Gjithashtu një takim përgatitor mes sekretarit amerikan të shtetit Marko Rubio dhe ministrit të jashtëm rus, Sergei Lavrov që do të mbahej këtë javë u pezullua. Shtëpia e Bardhë tha dyshja kishte zhvilluar një telefonatë shumë produktive dhe takimi nuk ishte më i nevojshëm. Të hënën Trump i dha përkrahjen një propozimi të mbështetur nga Kievi dhe liderët evropianë për të ngrirë konfliktin në vijën aktuale të fronti.

Por Moska e ka refuzuar vazhdimisht një ide të tillë, teksa kërkon të marrë të gjithë rajonin e Donbas. Ministri i Jashtëm Lavrov deklaroi se një zgjidhje e tillë nuk do të çonte drejt një paqeje afatgjatë.

GOTTFRIED WILHELM LEIBNIZ: KORRESPONDENCË MBI GJUHËN SHQIPE

Filozofi dhe matematikani gjerman, Gottfried Wilhelm Leibniz (1646–1716), ishte një figurë madhore e mendimit perëndimor. Lindi në Lajpcig, shërbeu si diplomat dhe jetoi për një pjesë të madhe të jetës në Paris. Më vonë shërbeu pranë Dukës së Brunsvikut në Hanover dhe u bë presidenti i parë i Akademisë Prusiane të Shkencave. Veprat e tij të gjera mbi filozofinë, matematikën, shkencën, historinë dhe jurisprudencën u shkruan në frëngjisht dhe latinisht. Leibniz ishte një njeri me interesa të shumta dhe madje u mor edhe me gjuhën shqipe, e cila në atë kohë ishte shumë pak e njohur. Më poshtë janë disa pjesë të shkëputura nga korrespondenca e tij.

Nga: Gottfried WILHELM LEIBNIZ[1]

Përktheu në anglisht (nga frëngjishtja): Robert Elsie
Përkthimi në shqip (nga anglishtja): Agron Shala / Telegrafi.com

I. Do të doja t’ju falënderoj që më informuat mbi ilaçin e Prorit të Kabrijerit. Ilaçe të tilla të provuara duhet të publikohen me detaje të përvojës me to. Ju përmendët disa të tjera.

II. Më trishton vdekja e Kontit të Shverinit. Ai ishte një njeri me dije dhe kureshtje, dhe ndihmonte në promovimin e studimeve dhe dijes. Disi dyshoj se z. Brand do t’i jepet tani pozicioni i drejtorit të Bibliotekës Mbretërore.

III. Nuk kam dyshim, Zotëri, se meritat tuaja do të vlerësohen gjithnjë e më shumë, pasi vërej që ata me pushtet janë të bindur për to. Po ashtu, shoh se jam in aere tuo pasi ju kam borxh [lutjen] Ati ynë në [gjuhën] hotentot. Ende nuk e kam gjetur, por jam i sigurt se e kam diku, ndaj do ta merrni një ditë, pa dyshim. Sa i përket gjuhës së shqiptarëve, kam përshtypjen se mund të jetë një lloj sllavishteje, pasi kjo gjuhë flitet përgjatë detit Adriatik. Ajo zakonisht njihet si Linguam Illyricam, por unë besoj se gjuha e ilirëve të lashtë ishte diçka krejt tjetër. Nëse do të kishte ndonjë mbetje të saj në malësitë e Epirit, kjo do të ishte padyshim shumë e pazakontë dhe mjaft e denjë për t’u hulumtuar. Kam menduar për këtë më shumë se një herë, por nuk më ra ndër mend kur isha në Romë, ku njihja z. Pastritio (nëse nuk gaboj), profesor në Kolegjin della propaganda (për Propagandimin e Fesë), i cili ishte vetë nga Dalmacia. Nuk e di nëse është ende gjallë. Kjo mund të mësohet në Raguzë (Dubrovnik) ose madje në Venedik, pasi territoret e Republikës janë shumë pranë Shqipërisë.

IV. Nëse do të më lejohet, Zotëri, do të doja t’ju inkurajoja të mësoni gjuhën kineze. Besoj,

ashtu si ju, se i ndjeri z. Muller, një njeri me dije, ka parë diçka interesante në të. Shpresoj që do të marrim një kopje të Fjalorit Tartar-Kinez të cilën Perandori i Kinës po përgatit, dhe u kam shkruar jezuitëve duke u thënë se do të ishte mirë që të kishte ndonjë shpjegues në një gjuhë evropiane. At Grimaldi nuk besonte se kishte një çelës për simbolet kineze. Por, duhet të ketë një arsye pse janë krijuar ashtu, edhe pse kalimi i kohës mund t’i ketë bërë të vështirë për t’u deshifruar dhe të ketë sjellë parregullsi në to.

V. Kam marrë dy fjalorë të gjuhës së Uellsit. I pari nga Davies u botua në Londër më 1632 in fol. dhe më është dërguar me një gramatikë të botuar in 12 më 1621. Fjalori i dytë uellsian është nga Thom. Jones, botuar in 12 më 1688. Ai përkthen nga gjuha uellsiane në anglisht, por jo anasjelltas. Ndërsa Davies jep gjuhën uellsiane në latinisht dhe nga latinishtja në gjuhën uellsiane. Ende jam i bindur se të paktën gjysma e gjuhës uellsiane ka lidhje me gjermanishten, dhe se ajo është në njëfarë mënyre si greqishtja ndaj latinishtes. Gjermanishtja e vjetër përmbante mjaft fjalë që sot nuk i kuptojmë. Më duket se britanikët e lashtë kanë ardhur nga Gjermania, dhe se galët etj. kanë diçka nga gjuha e kimbrianëve dhe gjermanëve të lashtë, nga të cilët ka mbetur shumë pak, dhe se irlandezët janë pasqyrë e një migrimi më të hershëm të britanikëve të vjetër, të cilët gjithashtu kaluan detin. Kështu, irlandishtja është një formë edhe më e vjetër e keltishtes. Ka njerëz në Angli që po punojnë aktualisht për të shpjeguar gjuhën irlandeze dhe do të isha shumë kureshtar të di se çfarë do të nxjerrin. Davies citon një Dictionarium Britannico-Aremoricum, botuar në Paris me impensis Yvonis Quillevère, më 1521. Por, mjaft me këtë.

VI. I kërkova z. Cuper përshkrimin kinez, por ende nuk e kam marrë. Ai më foli për një holandez që kishte kaluar shumë

kohë në Spanjë dhe shpresonte të mund të deshifronte alfabetin e lashtë spanjoll.

I. Mbi gjuhën shqipe, II. Mbi gjuhët armene, koptike dhe georgjiane etj., III. Mbi gjuhët e vendeve nën sundimin e Carit. I. Meqë z. Hubener po kalon këtej, në kthimin e tij nga Holanda, i kërkova të sigurojë një dorëshkrim në Bibliotekën Mbretërore, të cilin po ua dërgoj përsëri me falënderime, dhe kam nderin t’ju shkruaj njëkohësisht. U gëzova shumë kur dëgjova që keni marrë një libër dhe një Fjalor të Gjuhës Shqipe. Nga ky fjalor shohim se si mund të ketë qenë gjuha e ilirëve të lashtë. Megjithatë, vërej se ka shumë fjalë latine në të. Attyne për “Ati ynë” përputhet me gjuhët skite. Gjithashtu, duket se ka gjurmë të vogla fjalësh që i ngajnë gjermanishtes, si seet për “tokë”, Enandeyenée për “të falësh”, dhe ndetekech për “në tundim”.

II. Do të bëheni së shpejti universal në linguistikë, Zotëri, pasi po zgjeroni njohuritë tuaja edhe mbi armenishten, e cila është mjaft e ndryshme nga gjuhët e tjera. E dini se i ndjeri z. Acoluthus mendonte se kishte gjetur një lidhje midis armenishtes dhe koptishtes, por besoj se kishte gabuar, dhe të paktën nuk më dha ndonjë provë bindëse kur më foli në Berlin. Ju tani do të mund të bëni një vlerësim më të mirë. Gjuha georgjiane më është dukur më e pazakontë se armenishtja për shkak të shumësisë së mënyrave foljore që ka. Shpjegimi juaj për medaljet armene do të jetë i përshtatshëm si pjesë e Miscellanea-s sonë.

III. Këtu ndodhet një zotëri nga Moska, një i dërguar i Carit, i cili ndoshta do të qëndrojë për disa javë. E quan veten princ apo knjaz dhe është nga familja e vjetër Kurakin. Do të përpiqem ta bind të shkruajë në Kancelarinë e Moskës për të na siguruar mostra të gjuhëve të vendeve nën sundimin e Carit dhe të vendeve fqinje. Dhe, nëse keni ndonjë kërkesë, ju lutem më njoftoni sa më shpejt. Duke qenë vendas, ai mund të shkruajë më

lehtë sesa të huajt që janë në shërbim të Carit, të cilëve u kam shkruar dhe folur, por pa sukses. Për të tjerat, mbetem i juaji etj.

I. Mbi gjuhën shqipe, II. Gjuha georgjiane, III. Vepra e Nestorit të Kievit, IV. Pagëzimi i dytë i latinëve ndër rusë etj., V. Origjina e fjalës Kozak.

I. Do të ishte ide e mirë që në shqip të bëhej dallimi midis atyre që janë fjalë amtare dhe atyre që janë të huazuara. Askush nuk mund ta bëjë më mirë këtë se ju, Zotëri. Megjithatë, do të doja t’ju jap mendimin tim për disa fjalë të kësaj gjuhe. Hunde pro naso, an dicemus antiquum Celticum esse? (hunde për “hundë” - a mund të themi se kjo është keltishte e lashtë?) dhe fjala gjermane “Hund” (qen) mund të ketë marrë emrin nga hunda, për shkak të aftësisë për të nuhatur, ashtu si Truye “troia” (dosa e egër) vjen ndryshe nga trogue apo truyn, që do të thotë “hundë” në galishten e lashtë dhe te galët modernë gjithashtu. “Hunting” [gjuetia] në anglisht ka një kuptim, por “hint” është një gjurmë apo tregues, që gjermanët modernë do ta quanin Spuhr. Pra, është e mundur që të gjitha këto rrjedhin nga rrënja Kunde “knowledge” [njohje], nga e cila vjen connoître (të dish) në frëngjisht dhe gnóoskein në greqisht (të njohësh). Do të arrija në përfundime të ngjashme me craha (krahu) në shqip, sepse Krebs apo crabbe (gaforre) është një kafshë me krahë, dhe Krallen (kthetra), krazzen “me gërvish”, kriechen “me u zvarrit”, Kröte “bufo” (zhabë) duket se lidhen gjithashtu me këtë. Shkronja “k” në rrënjë shpesh shënon përkulje, ndërsa “r” një lëvizje, dhe krahët shpesh përshkruhen me kombinimin “cr”. Massa më duket se do të thotë “mish” në sllavisht. Kjo është bërë mix në shqip dhe mis në armenisht, që të dyja me kuptimin “mish”. Burri “maritus” (bashkëshort) mund të ketë lidhje me Braut (nuse), Bräutigam (dhëndër), Freia është perëndesha gjermane e dashurisë. Sa i përket gaforres, gaforreia në shqip, dyshoj se

mund të ketë lidhje me Gafel, pra furca “pirun”. Çizmet që hungarezët i veshin zakonisht quhen citmes në Vjenë, me shqiptimin italian, pra tschismes. Duhet parë gjithashtu nëse ocrea nuk është e njëjta gjë me tschisme në hungarisht ose ndonjë vend fqinj, siç është në shqip. Fjalët shqipe për numrat nuk kanë asgjë që të mund të jetë huazuar nga gjuhët fqinje, por, meqë ju njihni të gjitha këto gjuhë, do të mund të kuptoni pse shqiptarët e quajnë kaun chau, dhe detin deet, “mulier” (grua) crue dhe “mirë” emir. Ndoshta deet vjen nga delt, pra thalassa etj.

(Hanover, 26 dhjetor 1709)

II. Me këtë rast, do t’ju lutesha, Zotëri, të më dërgoni lutjen Ati ynë në gjuhën epirote (shqipe) në një version interlinear dhe do t’ju isha shumë mirënjohës nëse do të mund të shtonit edhe Besoj nëse është e mundur. Ju lutem gjithashtu të më dërgoni titujt e dy librave në këtë idiomë, përmasat dhe datën e vendin e botimit, sepse kjo gjuhë, që është pak e njohur, është e denjë për t’u studiuar. Do të përpiqem t’i gjej këta libra në Romë. Me ta janë zhgroposur monumentet e lashta nga themelet e Notre-Damit në Paris.

(Hanover, 28 dhjetor 1711)


... Alfabetet moderne evropiane rrjedhin nga latinishtja, përjashtuar dy alfabetet sllave: cirilik dhe të ashtuquajturin glagolitik. Disa autorë më vonë ua atribuojnë këto Shën Jeronimit, i cili ishte me origjinë ilire, por kjo është e rreme, sikur gjuha e lashtë ilire të ishte një lloj sllavishteje. Por, sllavët mbërritën vonë në Iliri, jo para epokës së Justinianit. Ilirët e lashtë ishin me origjinë kelte. Ata përdornin një gjuhë të afërt me gjermanishten dhe galishten. Është e qartë se mbetje të saj ruhen në gjuhën moderne, sidomos në atë të epirotëve, për të cilën kam parë mostra të botuara. Sot zakonisht e quajnë sllavishten “ilirike” sepse sllavët u vendosën në Iliri ...

(Vjenë, 13 janar 1714)

II. Një ditë në Berlin më dhatë një libër në gjuhën e epirotëve, i shtypur në Romë nga Propaganda Fide. Besoj se përmbante lutjen Ati ynë në atë gjuhë dhe e nxora. Por, nuk e gjej dot lehtësisht mes letrave të mia. A do të kishit mundësi, Zotëri, të ma dërgonit edhe një herë?

(Hanover, 24 mars 1715)

[1] Gottfried Wilhelm Leibniz, Opera Philologica (Hildesheim: Georg Olms, 1989). Përkthyer nga frëngjishtja nga Robert Elsie.



Askush si PSG-ja në Ligën e Kampionëve, hyn në histori me rekordin e jashtëzakonshëm

PARIS, 22 TETOR - Paris Saint-Germain (PSG) është skuadra e parë në historinë e Ligës së Kampionëve që shënon 40 ose më shumë gola në Ligën e Kampionëve brenda një viti të vetëm. Parisienët e kanë arritur këtë sukses në ndeshjen e tyre kundër Bayer Leverkusenit, ku

kanë shënuar shtatë gola në fitoren e thellë 2-7. Me atë ndeshje, PSG-ja e ka arritur shifrën e 40 golave dhe ka shtuar pesë të tjerë, që do të thotë se ka shënuar 45 gola në Ligën e Kampionëve këtë vit. Është më se e përshtatshme që kampionët në fuqi do të mbajnë një nder të tillë në garën

prestigjioze të Evropës. Luis Enrique ka deklaruar se qëllimi kryesor i PSG-së është ta mbajë trofeun për të dytin sezon radhazi. Ndryshe, PSG-ja e ka fituar trofeun në edicionin e fundit duke mposhtur Interin në finale, teksa këtë edicion ka shënuar tri fitore nga po kaq ndeshje.



FFK-ja ME HAPA TË RËNDËSISHËM PËR SIGURINË NË FUTBOLL, SHPËRNDAN DEFIBRILATORË MODERNË PËR KLUBET

PRISHTINË, 22 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në kuadër të një projekti të mbështetur nga programi "UEFA HatTrick", ka ndërmarrë një iniciativë të rëndësishme që synon rritjen e sigurisë në fushat e futbollit. Nëpërmjet këtij projekti të gjitha klubet e Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës së Dytë, si dhe klubet e vajzave, janë pajisur me defibrilatorë të teknologjisë më të avancuar, të cilët mund ta bëjnë ndryshimin mes jetës dhe vdekjes në rastet e urgjencave shëndetësore. Në dekadën e fundit raste të rënda shëndetësore të ndodhura në fushën e gjelbër kanë nxjerrë në pah rëndësinë e pajisjeve mjekësore si defibrilatori, i cili mund të shpëtojë jetë në rast të arresteve kardiake. Përveç shpërndarjes së pajisjeve, projekti është shoqëruar edhe me organizimin e trajnimeve dhe fushatave për ndërgjegjësim rreth përdorimit të saktë dhe të shpejtë

të defibrilatorëve, ku ligjërues ishte stafi mjekësor i Kombëtares A të Kosovës, duke ndarë përvojat e marra nga trajnimet e UEFA-s. Trajnimet në fushën e shëndetit në futboll do të vazhdojnë dhe FFK-ja do të punojë ngushtë me klubet për të siguruar që çdo ekip të ketë personel të trajnuar që di të reagojë menjëherë në raste emergjente. Ky projekt është një hap domethënës jo vetëm për sigurinë, por edhe për profesionalizimin e mëtejshëm të futbollit të Kosovës, duke ndjekur standardet evropiane të kujdesit shëndetësor në sport. Mbështetja e UEFA-s përmes programit "HatTrick" është një konfirmim i mëtejshëm i besimit dhe përkushtimit që ky institucion ka ndaj zhvillimit të futbollit në Kosovë. Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, e ka vlerësuar këtë projekt jo vetëm si investim në pajisje, por edhe si investim në jetë, në siguri dhe në të ardhmen e futbollit të



Kosovës, meqë futbollit ynë është përballur me humbje jetësh në fushat e gjelbra. "Në një kohë kur sporti gjithnjë e më shumë po konsiderohet jo vetëm si argëtim, por edhe si një aktivitet që kërkon kujdes të madh për mirëqenien fizike dhe psikologjike të sportistëve, ky projekt tregon qartë që siguria dhe shëndeti i lojtarëve janë prioritet absolute

për Federatën e Futbollit të Kosovës", ka thënë Ademi. Ndërsa mjeku i Kombëtares A të Kosovës, Amir Vejseli, ka thënë se defibrilatori është pjesë jetike dhe urgjente që duhet të jetë i pranishëm në çdo ndeshje futbollit. "Defibrilatorët janë kërkesë urgjente, meqë kjo pajisje mund të jetë jetike për rastet e sulmeve kardiake që

mund të ndodhin gjatë ndeshjeve dhe seancave stërvitore. Pjesa e organizimit mjekësor në një ndeshje futbollit është po aq e rëndësishme sa edhe organizimi sportiv", ka thënë ai. FFK-ja mbetet e përkushtuar për të garantuar një ambient më të sigurt për të gjithë aktorët e përfshirë në lojën e futbollit, që nga lojtarët e rinj e deri tek ata profesionistë, përfshirë trajnerët, stafin teknik dhe zyrtarët e ndeshjeve.



FILLON SEZONI I RI NË NBA: LAKERSI MPOSHTET NË SHTËPI, OKLAHOMA MERR FITORE PAS KOHËS SHITESË



Sezoni i 80 i Asociacioni Kombëtar të Basketbollit (NBA) ka nisur me spektakël të madh dhe dy ndeshje emocionuese. Në sfidën hapëse, kampionët në fuqi të Oklahomës kanë mposhtur Houston Rocketsin pas dy kohëve shtesë me rezultat 125:124, në një ndeshje që ka dhuruar drithërima deri në sekondat e fundit. Heroi i ndeshjes ishte Shai Gilgeous-Alexander, i cili fillimisht ka barazuar rezultatin për ta

dërguar ndeshjen në shtesë, e më pas e ka vulosur fitoren me një tjetër kosh në sekondat e fundit. Ylli kanadez e ka mbyllur duelin me 35 pikë, 5 ribaunde dhe 5 asistime, duke udhëhequr Oklahomën drejt fitores së parë sezonale. Atij i është bashkuar edhe Chet Holmgren me 28 pikë dhe 7 kërcime, duke treguar se Thunder do të jetë sërish forcë e frikshme këtë sezon. Në krahun tjetër, Alperen Sengun ka

shkëlqyer me 39 pikë, 11 kërcime dhe 7 asistime, ndërsa Kevin Durant ka shtuar 23 pikë e 9 kërcime për Houstonin që, megjithatë, ka dalë pa shpërblim nga kjo përballje epike. Në ndeshjen tjetër, Golden State Warriors ka mposhtur LA Lakersin me rezultat 119:109, në një duel ku ka munguar LeBron Jamesi, i cili për herë të parë në karrierë nuk ka luajtur në hapje të sezonit.

Anulohet ndeshja e La Ligas në ShBA

MADRID, 22 TETOR - La Liga ka njoftuar se ka hequr dorë nga organizimi i ndeshjes Villarreal - Barcelona në Miami të ShBA-së. Liga spanjolle ka bërë me dije se ka anuluar vendimin për shkak të paqartësive që janë shfaqur ditët

e fundit në Spanjë. Përballja Villarreal - Barcelona është caktuar të luhet më 20 dhjetor, por jo në Miami dhe shkas për këtë duket se janë bërë protestat nëpër stadiumet e shumta të Spanjës.

Në fillim të tetorit La Liga ka njoftuar se ka zhvendosur ndeshjen në Florida, por kjo solli reagime të shumta në Spanjë. Lojtarët, përfshirë edhe ata të Villarrealit e Barcelonës, kanë protestuar duke qëndruar pa

lëvizur për 15 sekonda në ndeshjet e fundit, gjë që nuk është shfaqur në transmetuesit zyrtarë. Liga spanjolle ka vlerësuar se projekti prezantonte mundësi unike për "ndërkombëtarizimin e futbollit spanjoll".



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Brickos Solar” shpk, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Sistemin Fotovoltaik (me kapacitet 2.3 MW (DC)) Z.K. Berivojcë, Kamenicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.12.2025 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Kamenicës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Brickos Solar” shpk, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/5672762556?pwd=XwECUSD5Yga3nINaHaCHtagIKtyEOy.1&omn=87209700327>

Meeting ID: 567 276 2556

Passcode: p2piEe

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Brickos Solar” shpk, Kamenicë, për Pëlqim Mjedisor, – për Sistemin Fotovoltaik (me kapacitet 2.3 MW (DC)) Z.K. Berivojcë, Kamenicë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “1AR Clothing” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812294817 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “1AR Clothing” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812294817 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “1AR Clothing” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812294817 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim për Zvogëlim të Kapitalit Themelor

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Virtus Auto” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. Nënë Tereza, Zona Industriale PN, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me numër unik identifikues (NUI) 811557480, njofton publikun dhe kreditorët se ka marrë vendim për zvogëlim të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë zvogëlohet nga shuma katërqind mijë (400,000.00) euro në shumën dyqind mijë (200,000.00) euro, sipas Vendimit të datës 28 gusht 2025.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë ftohen që, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga publikimi i këtij njoftimi, të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim në adresën e shoqërisë ose përmes emailit zyrtar të saj.

Data: 28.08.2025

Virtus Auto SH.P.K.

(Prishtinë, rr. Nënë Tereza, Zona Industriale PN)

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

“Prime Invest Group” SH.P.K.
me numër Unik Identifikues:
812182450, Prishtinë me pronar
Murat Kuka dhe Shaban Çetaj bënë
shpallje në gazetë për zvogëlim të
kapitalit nga 750.000 Euro në
50.000 mijë Euro.

- Irfan Hodaj shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” në Nashec.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.
- Blerim Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale Teknike “Gani Qfderbasha” Prizren.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

